- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër penale ose kundërvajtje të lidhura me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit ose të prokurorit publik.".

Paragrafi (7) shlyhet.

Neni 11

Në nenin 40 paragrafi (2) alineja 2 ndryshohet si vijon:

"-nëse me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim apo sanksioni për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës për veprën penale apo kundërvajtjen lidhur me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit apo prokurorit publik,".

Në alinenë 3 pika zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohet alineja e re 4, si vijon:

"-nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e rregullave nga sfera e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.".

Neni 12

Në nenin 45 paragrafi (1) fjala "gjashtë" zëvendësohet me fjalën "tetë".

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Ligjërues mund të caktohet personi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni i cili i përmbush kushtet në vijim:

- me aktgjykim të plotfuqishëm të mos jetë i dënuar për vepër penale me dënim me burg pakusht prej së paku gjashtë muajsh,

- me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim apo sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës për veprën penale apo kundërvajtjen lidhur me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit apo prokurorit publik.".

Neni 13

Në nenin 48 paragrafin (1) fjala "gjashtë" zëvendësohet me fjalën "tetë".

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Mentor mund të zgjidhet personi i cili me aktgjykim të plotfuqishëm nuk është dënuar për vepër penale me dënim me burg pakusht prej së paku gjashtë muajsh dhe me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës për veprën penale apo kundërvajtjen lidhur me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit apo prokurorit publik.".

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragraf (6) fjalët: "paragrafi (1)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafët (1) dhe (5)".

Neni 14

Në nenin 57 paragrafi (1) alineja 1 ndryshohet si vijon:

"-të jetë jurist i diplomuar me arsim të lartë të kryer katërvjeçar shkalla VII/I të studimeve juridike apo jurist i diplomuar me 300 kredi të marra sipas Sistemit Evropian për Transfer të Kredive (SETK),".

Alineja 7 ndryshohet si vijon:

"-në mënyrë aktive ta njohë njërën nga tri gjuhët më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht apo gjermanisht), që përcaktohet në kuadër të provimit pranues në Akademi.".

**Dispozita kalimtare dhe të fundit**

Neni 15

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, Shoqata e Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë, Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë, Shoqata e Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë dhe ministri i Drejtësisë më së voni në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të emërojnë anëtarë të Këshillit Drejtues dhe zëvendës të tyre, në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Mbledhjen konstitutive të Këshillit Drejtues do ta konvokojë dhe atë do ta kryesojë anëtari më i vjetër i emëruar i Këshillit Drejtues dhe ajo do të mbahet në afat prej 15 ditësh nga emërimi i anëtarëve dhe zëvendësve të tyre të Këshillit Drejtues në pajtim me këtë ligj.

Këshilli Drejtues në mbledhjen konstitutive do ta miratojë edhe vendimin për shpalljen e konkursit publik për drejtor dhe zëvendësdrejtor në pajtim me kushtet e këtij ligji.

Këshilli Drejtues do t'i emërojë anëtarët dhe zëvendësanëtarët e Këshillit Programor të Akademisë në pajtim me kushtet e këtij ligji më së voni në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 16

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

---

**2980.**

Врз основа на членот 68, став 2 од Уставот на Република Македонија и членот 43 став 2 од Законот за народниот правобранител („Службен весник на Република Македонија“ број 60/2003, 114/2009, 181/16, 189/16 и 35/18), Собранието на Република Македонија, на седницата одржана на 3 септември 2018 година, донесе

**ОДЛУКА**
**ЗА ДАВАЊЕ СОГЛАСНОСТ НА ОПШТИТЕ АКТИ НА НАРОДНИОТ ПРАВОБРАНИТЕЛ**

Член 1

Собранието на Република Македонија дава согласност на:

- Правилникот за изменување и дополнување на Правилникот за организација и делокруг на работата на Стручната служба, Тимот на Националниот превентивен механизам, Посебните одделенија и Канцелариите на народниот правобранител и на

- Правилникот за изменување и дополнување на Правилникот за систематизација на работните места во Стручната служба, Тимот на Националниот превентивен механизам, Посебните одделенија и Канцелариите на народниот правобранител.

Член 2

Оваа одлука влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

| | |
|---|---|
| Бр. 08-5116/1 | Претседател на Собранието |
| 3 септември 2018 година | на Република Македонија, |
| Скопје | м-р **Талат Џафери**, с.р. |